



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



DORACAK PËR PËRDORIMIN E KRITERIT TË SHPËRBLIMIT

“Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF)”

Përmbledhje

PARATHËNIE	3
KORNIZA LIGJORE	5
KRITERET E DHËNIES - RREGULLAT BAZË	8
KRITERI - ÇMIMI MË I ULËT	9
KRITERI - TENDERI EKONOMIKISHT MË I FAVORSHËM (TEMF)	11
1. PËRCAKTIMI i pikëve maksimale të OFERTËS TEKNIKE DHE FINANCIARE	13
2. IDENTIFIKIMI I ELEMENTEVE TË OFERTËS TEKNIKE PËR VLERËSIM	15
<i>Shembull i prokurimit për Furnizime - Blerja e printereve laser</i>	16
3. PËRCAKTIMI I KRITEREVE TË VLERËSIMIT	18
4. PËRCAKTIMI I PIKËS MAKSIMALE QË DO TI CAKTOHET SECILIT KRITER TË VLERËSIMIT, duke specifikuar metodën e atribuit (shpërndarjes)	22
Llojet e kriterëve të shpërblimit	23
1) Kriteret që ndërlidhen me kosto (financiare)	23
2) Kriteret cilësore	24
<i>Shembull i prokurimit për Furnizime - Blerja dhe instalimi i aparaturës radiologjike XRY</i>	25
<i>Shembull për Furnizim me automjete</i>	26
<i>Shembull për Furnizim me Kamionçinë</i>	28
<i>Shembull për Autoambulanca</i>	30
<i>Shembull: Vlerësimi i kombinuar në shërbime të konsulences</i>	33
<i>Shembull i prokurimit për Pune: Ndërtimi i rrugës “X”</i>	34
<i>Shembull i prokurimit për Pune: Ndërtimi i tregut të gjelbërt</i>	35
3) Kriteret kontraktuale	36
4) Kriteret e Qëndrueshme	37

PARATHËNIE

Rezultati i suksesshëm i një aktiviteti të prokurimit, në drejtim të arritjes së **niveleve të pritura cilësore dhe sasiore**, varet në masë të madhe nga kapaciteti i Autoritetit Kontraktues (AK) në përgatitjen dhe udhëheqjen e procedurës së prokurimit.

Për këtë qëllim, është e nevojshme që AK-se të zhvillojnë metodologji adekuate për individualizimin e nevojave të tyre dhe vlerësimin e tenderëve të dorëzuar, të përshtatshme për të stimuluar në mënyrë adekuate operatorët ekonomik (OE) në treg për të identifikuar zgjidhjet e duhura që përputhen në mënyrën më të mirë të mundshme me nevojat e vetë AK-së.

Metodologji të tilla, të paracaktuara në dosjen e tenderit, krijojnë nëpërmjet procedurës së prokurimit një sistem ndërveprimi të heshtur ndërmjet AK dhe OE. Procesi konkurrues, duke **përcaktuar në dosjen e tenderit pritshmëritë dhe objektivat e AK-së**, u mundëson OE-ve të paraqesin kombinimin ideal të kushteve teknike dhe financiare të aftë për të maksimizuar jo vetëm komoditetin e tyre, por edhe nevojat dhe kërkesat e vetë AK-së.

AK është i detyruar të vlerësojë ofertat në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Zgjedhja e kriterëve të dhënies dhe modelit të vlerësimit është thelbësore që AK të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm nga prokurimi, d.m.th. ai që korrespondon më mirë me nevojat e identifikuar.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/l-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092 (në tekstin e mëtejshëm ‘LPP’), kriteret e dhënies janë:

- a. çmimi më i ulët; ose
- b. tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF).

Zgjedhja midis këtyre dy opsioneve është lënë në diskrecionin e AK. Nëse AK zgjedh të aplikojë TEMF, zgjedhja e ofertës më të mirë bazohet në kombinimin e faktorëve të zgjedhur nga AK. LPP-ja parashikon një listë jo shteruese të faktorëve të tillë si: cilësia, çmimi, meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, karakteristikat mjedisore, kostot e funksionimit, efektiviteti i kostos, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike. Lista jo shteruese do të thotë se AK mund të përcaktojë, varësisht nga natyra e aktivitetit të prokurimit, edhe faktorë të tjerë nga ato të përcaktuara në LPP.

Prandaj, zgjedhja e kriterit të duhur të shpërblimit ndërmjet dy të lartpërmendurve përfaqëson një moment themelor në një procedurë tenderimi. Një zgjedhje e tillë rezulton në një **mundësi konkrete rritjeje për tregun, nxitjen për inovacion, arritjen e interesave publike dhe produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e shpenzimeve publike**.

Qëllimi i **kriterit TEMF** në një procedurë tenderimi është të zgjedhë ofertën që ofron vlerën më të mirë për parandë, që nënkupton kombinimin optimal midis cilësisë (duke iu referuar elementëve që nuk lidhen me koston) dhe çmimit/kostot (duke iu referuar elementeve në lidhje me koston), duke përfshirë aspektet mjedisore dhe sociale, që së bashku plotësojnë nevojat e AK.

Përdorimi i kriterit TEMF në fakt paraqet një **sfidë për qeveritë në drejtim të modernizimit, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.**

Megjithatë, sipas statistikave kombëtare, vlera e pjesës së kontratave të nënshkruara të dhëna sipas kriterit TEMF në Kosovë në vitin 2019 ishte e kufizuar në 0.78% të vlerës totale të kontratave të nënshkruara; ndërsa në vitin 2020, kjo vlerë është ulur në 0,37 % të totalit.

Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën kanë theksuar më tej se parimet përkatëse që qëndrojnë në themel të kriterit TEMF, siç është raporti më i mirë çmim-cilësi dhe kostot e ciklit jetësor të produktit, nuk zbatohen. AK-ese të Kosovës kryesisht i rikthehen kriterit të çmimit më të ulët për blerjet e tyre, me pasojë që blerjet e tilla mund të vuajnë nga cilësia e dobët.

Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së njohurive dhe kapaciteteve të AK-ese se si të konvertojnë parimet teorike – siç parashikohen në legjislacion – në dispozita praktike dhe funksionale në dokumentet e tyre të tenderit. Prandaj, **Doracaku aktual** synon të ofroj udhëzime për AK-ese për qëllime të verifikimit të ekzistencës së kushteve për përdorimin e kriterit të **TEMF** dhe ofron asistencë për AK-së për zbatimin më të përshtatshëm të tij.

KORNIZA LIGJORE

Neni 52 i LPP-së i referohet kriterëve të dhënies. Në veçanti, rregullat në lidhje me kriterin e TEMF parashikohen në paragrafët nga 1 deri në 5 të nenit të sipërpërmendur.

Nga ana tjetër, legjislacioni dytësor parashikon kriterin e TEMF në nenin 27 të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme “RRPP”)**.

Neni 52 i LPP

Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

- 1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.*
- 2. Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t'i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre.*
- 3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencat teknike.*
- 4. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kriterëve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kriterëve.*
- 5. Në rast të kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm është e detyrueshme që të konvertohet çdo element i kriterëve të dhënies në pikë dhe më pas të peshohet në bazë të formulës dhe peshave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit.*

Rregullorja 01/2022 për Prokurimin Publik

27.1 Autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin të bëjnë dhënien e kontratës në bazë të kriterit:

- a. Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë, ose*
- b. Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm.*

27.2 Kriteret tjera të dhënies përveç atyre të specifikuara në paragrafin 27.1 nuk lejohen.

27.3 Nëse kriteri “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë” është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuara.

Nëse kriteri është ‘tenderi ekonomikisht më i favorshëm’, kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit AK mund të përfshijë kriteret tjera relevante për lëndën e kontratës, siç janë: a. Karakteristikat e cilësisë b. Kostot Operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë c. Karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme

d. Shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike.

27.4 Kriteret duhet të përcaktohen me peshë sipas rëndësisë relative.

27.5 Për Konkurse të Projektimit dhe shërbime të konsulencës kritere tjera mund të konsiderohen. Referohuni në nenin 57 (Konkurs të Projektimit) dhe nenin 59 (shërbime të konsulencës) të kësaj rregullore.

27.6 Kriteret e përzgjedhura për dhënies të kontratës duhet të specifikohen në Njoftim për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit.

27.7 Kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit “tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e peshëve relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter. Ato duhet të para-vendosen dhe të bëhen të ditura për tenderuesit. Kritere të reja ose të amandamentuara nuk duhet të prezantohet gjatë procedurës së dhënies së kontratës. Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit.

27.8 Është obligim i Departamentit / Njësisë së Prokurimit/ të siguroj që blerja më e mirë (vlera ekonomikisht më e favorshme) të sigurohet duke marrë parasysh kombinimin optimal të kostos, të cilat do të përfshijë kostot totale të ciklit të jetës së mallrave, punëve ose shërbimeve. Është e nevojshme të shikohen të gjitha kostot që do të kontribuojnë kostot e mirëmbajtjes dhe kostot Operative të projektit që do të jenë të arsyeshme, gjatë jetë gjatësisë së projektit. Nuk është vetëm kostoja e artikujve, mallrave ose shërbimeve në tender, por përfshirja e të gjitha kostove, direkte dhe indirekte, siç janë:

Kostoja e artikujve + Kostot operative

Kosto e artikullit + Kostot e artikujve të shpenzueshëm (artikujt e përdorur me pajisje)

Kosto e artikullit + Kostot funksionale (kostot Operative)

Kosto e artikullit + Resurset njerëzore të përfshira (kostot e fuqisë punëtore)

Kosto e artikullit + Kostoja e listës së pjesëve rezervë të rekomanduara

Kosto e artikullit + Kostot e mirëmbajtjes / kostot e serviseve (javore, mujore)

Kosto e artikullit + Kostot e riparimit

Kosto e artikullit + përfshira e kostove të qirasë ose lizingut

Kosto e artikullit + Sigurimi

Kosto e artikullit + Konsideratat për ndikimin në mjedis

Kosto e artikullit + Konsideratat shëndetësore dhe të sigurisë

27.9 Tenderët duhet të vlerësohen objektivisht dhe në mënyrë transparente krahas kritereve të peshuara të publikuara. Objektiviteti dhe transparenca arrihet në mënyrën më të mirë me përdorimin e sistemit të vlerësimit me pikë ose shënimeve të pikëve të vlerësuara bazuar në kriteret e peshuara, që tregojnë një vlerësim krahasues të tenderëve nën secilin kriter.

27.10 Kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Tenderuesit do të konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetin e tyre për të përformuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kritere në procesin e dhënies së kontratës.

27.11 Gjatë përdorimit të kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm është e detyrueshme që të konvertohet çdo element i kritereve të dhënies në pikë dhe me pas të peshohet në bazë të formulës dhe peshave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit.

Rregullat kryesore të përcaktuara nga legjislacioni primar dhe sekondar të Republikës së Kosovës janë si në vijim:

- Mund të përdoren vetëm dy kritere të dhënies (neni 52.1 i LPP):
 - o **Çmimi/kostoja më e ulët;**
 - o **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm.**

- **Asnjë kriter tjetër** përveç atyre të lartpërmendurve, sipas nenit 27.1 të RRPP, nuk lejohet. Zgjedhja e **kriterit të dhënies** varet nga diskrecioni (dhe kompetenca) i AK-së përkatëse. Në çdo rast, duke iu referuar nenit 27.3 të RRPP, ku çmimi është kriteri i vetëm, kontrata do t'i jepet tenderit me çmimin më të ulët që është në përputhje me kërkesat e specifikuar;

- Dokumentet e tenderit **duhet të tregojnë kriterin e dhënies** dhe të ofrojnë **kriteret e vlerësimit** dhe **peshën e caktuar**, në lidhje me rëndësinë e tyre, për secilin kriter vlerësimi (Neni 52.1 i LPP);

- Kriteret e vlerësimit do të përcaktohen në mënyrë **objektive dhe të matshme** dhe do të lidhen **me objektin e kontratës** (neni 52.3 i LPP);

- Kriteret e vlerësimit **lidhen, por nuk kufizohen në:** cilësinë, çmimin, meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, karakteristikat mjedisore, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, efektivitetin e kostos, shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike (neni 52.3 i LPP);

- Vlerësimi do të konvertohet në pikë dhe, në këtë mënyrë, i matshëm (neni 52.5 i LPP);

- Kriteret e vlerësimit nuk i referohen **kritereve të përzgjedhjes** (neni 52.4 i LPP);

- Kriteret e vlerësimit nuk duhet të **ndryshohen apo ndryshohen** gjatë procedurës së tenderit (neni 27.7 i RRPP);

- Kur i referohemi çmimit, duhet të merren parasysh, përveç çmimit të blerjes, edhe **kostot që lidhen me kostot e të gjithë ciklit jetësor** të mallrave, punëve ose shërbimeve. Pra, kostoja totale do të përcaktohet nga çmimi që do të paguhet dhe nga kostot operative, instalimi, mirëmbajtja, kriteret mjedisore dhe sociale që lidhen me blerjen specifike (neni 52.3 i LPP-së dhe 27.8 i RRPP).

KRITERET E DHËNIES - RREGULLAT BAZË

AK mund të formulojë dosjet e tenderit në mënyra të ndryshme, duke i përshtatur ato me rrethanat specifike dhe nevojat e tyre. Gjithmonë duhet pasur parasysh që efektin që duhet të arrihet është ai i ekzekutimit të duhur të kontratës brenda kushteve më të mira të mundshme të tregut.

Informacioni më i rëndësishëm që duhet të specifikohet në dosjen e tenderit është:

- a. Përshkrimi i lëndës së prokurimit
- b. kriteret e përzgjedhjes
- c. kriteret e dhënies
- d. kontrata duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.

Një nga faktorët më të rëndësishëm në këtë proces është përcaktimi i drejte i kriterëve të dhënies.

Kërkesat për operatorët ekonomik vendosen në dy mënyra:

- a. **si kushte minimale** që duhet të përmbushen; dhe
- b. **si preferenca** që mund të përmbushen në shkallë të ndryshme.

Çdo tender duhet të jetë në përputhje me kushtet minimale që duhet të përmbushen për të qenë i përshatshëm për vlerësim të mëtejshëm. Ato vlerësohen si *'kalon/nuk kalon' ose 'po/jo'*.

Mënyra e dytë ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve të dhënies duke vendosur kriteret në nivele minimale si dhe piket në nivele të matshme për çdo shtese nga ato minimale e të cilat do të përdoren për vlerësimin e tenderëve.

Prandaj, AK, pas përcaktimit fillestar të kërkesave, duhet të pyesë veten nëse të gjitha këto kërkesa janë të nevojshme apo nëse disa prej tyre janë të dëshiruara. Kërkesat e dëshiruara duhet të hiqen nga dosja e tenderit apo të formulohen në formën e kriterëve të dhënies duke dhënë pike shtese për OE të cilët i ofrojnë me se miri. Kjo ju lejon të zgjidhni ofertën që siguron ekuilibrin më të mirë të çmim-cilësi.

Me kriteret e dhënies së kontratës, AK ua komunikon preferencat¹ operatorëve ekonomikë. Detyra e OE është që të paraqesin një tender që ka shansin më të madh të përzgjedhjes dhe që korrespondon me kërkesat dhe nevojat e AK.

¹ Përparësitë e nen-kritereve

KRITERI - ÇMIMI MË I ULËT

Sipas nenit 27.3 të RRPP, “ Nëse kriteri “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuar”.

Në përgjithësi, AK-të do të përdorin këtë kriter kur, në përcaktimin e karakteristikave të kontratës dhe nevojave të tyre specifike, i vetmi faktor relevant është **çmimi** . Konsideratat e **cilësisë nuk kanë rëndësi** në këtë zgjedhje.

Çmimi mund të shprehet edhe në terma të kostove duke pasur parasysh jo vetëm çmimin e paguar për blerjen, por edhe **për të gjithë ciklin e jetës** së mallrave, shërbimeve dhe punëve objekt i kontratës.

Përveç rastit të përmendur në nenin 27.3 të RRPP, përdorimi i kriterit çmimi më i ulët përbën **një opsion dhe jo një detyrim për AK**, i cili në çdo rast mund t'i rikthehet kriterit TEMF nëse konsiderohet më i përshtatshëm.

Prandaj, siç u tha më parë, ku i vetmi element i rëndësishëm i blerjes është çmimi/kostoja, dhe cilësia nuk ka rëndësi, **kriteri i çmimit më të ulët është në çdo rast i preferueshëm** pasi zvogëlon kohëzgjatjen, kompleksitetin dhe barrën administrative që lidhet me kryerjen e procedurës së tenderimit. AK-ja do të shqyrtoj në mënyrë adekuate një vendim të tillë në **fazën fillestare** të procedurës, duke pasur parasysh nevojat e saja specifike, karakteristikat e kontratës dhe tregun e referencës.

KUR PËRDORET KRITERI MË ÇMIMIN ME TË ULËT

Përdorimi i kriterit “çmimi më i ulët” rekomandohet në rastet e mëposhtme:

- **Çmimi është veçoria e vetme e rëndësishme e blerjes.** Për AK-në është e rëndësishme vetëm ajo që duhet blerë nën kushte të paracaktuara dhe çmim përkatës, pa asnjë implikim sa i përket karakteristikave dhe elementeve të cilësisë.
- **Blerjet e standardizuara:** blerjet që nuk mund të modifikohen me kërkesë të autoritetit kontraktues për shkak të natyrës dhe/ose ciklit prodhues (p.sh. ujë, benzinë, energji elektrike, gaz natyror, softuer, etj.); ose furnizime, karakteristikat teknike të të cilave janë të paracaktuara saktësisht në standardet teknike (në nivel kombëtar, evropian ose ndërkombëtar) dhe për të cilat nuk ka nevojë të merren, gjatë procedurave të tenderimit, oferta të ndryshme për t'u krahasuar për nga cilësia.
- **Blerjet e përsëritura dhe kontratat me vlerë të ultë,** kur karakteristikat e prokurimit janë të tilla që imponojnë blerjen e mallrave/shërbimeve/punëve me kushte tashmë të njohura për autoritetin kontraktues ose kur, për kontratat me vlerë të kufizuar, avantazhet e pritshme, sa i përket cilësisë janë të kufizuara në lidhje me shpejtësinë e procedurës. Për shembull, të gjitha rastet kur AK përgatit projektin ekzekutiv dhe nuk kërkon konkurs për vetë projektin; ose blerjet ku AK-ja ka fituar një përvojë të madhe për shkak të përsëritshmërisë periodike të asaj blerjeje. Më në përgjithësi, në të gjitha ato raste përfitimet që rrjedhin nga konkurrenca për raportin më të mirë cilësi/çmim janë zero ose shumë të ulëta.

Kurdo qe përdoret kriteri me çmimin më të ulët:

- tenderët duhet të jenë në përputhje me **specifikimet minimale teknike** të parapara në dosjen e tenderit;
- **nuk do t'i jepet asnjë avantazh asnjë tenderi që ofron specifikime më të mira mbi minimumin e përcaktuar;**
- **asnjë kriter tjetër vlerësimi nuk mund të përcaktohet përveç çmimit;**

Ofertat do të vlerësohen sipas **sistemi kalon ose dështon (po/jo)** .Tenderi i **përzgjedhur** do të jetë ai që përmbush specifikimet minimale të përcaktuara në dosje të tenderit dhe paraqet çmimin/kosto më të ulët.

KUFIZIMET NË PËRDORIM TË ÇMIMIT MË TË ULËT

Përdorimi i çmimit më të ulët paraqet disa **kufizime** në raport me kriterin TEMF

- nuk **merr parasysh aspektet cilësore**. Përveç aspektit cilësor të përcaktuar në specifikimet e paracaktuara që duhet të plotësojnë të gjithë tenderët, cilësia e prokurimit nuk është objekt vlerësimi;
- nuk lejon marrjen parasysh **të inovacionit dhe zgjidhjeve inovative**.

KRITERI - TENDERI EKONOMIKISHT MË I FAVORSHËM (TEMF)

Ky kriter përdoret kur AK dëshiron të siguron se kontrata do t'i jepet operatorit ekonomik tenderi i te cilit ofron vlerën më të mirë për parat.

Termi **vlerë për para** tregon kombinimin optimal (kombinim) ndërmjet **kostos** (si çmim) dhe kostot e ciklit jetësor të mallrave, punëve ose shërbimeve, dhe **elementet cilësore të tenderit** (funktionale, teknike, mjedisore, estetike, sociale), në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat e AK-së.

Ne këtë rast:

- AK ka mundësinë që të përcaktojë specifikimet për kontratë duke u përqëndruar më tepër mbi performancën funksionale (efektshmërinë) sesa në kërkesat strikte teknike.
- Dorëzimi i varianteve lejohet, po që se këto përmbushin kërkesat minimale të specifikuara.
- Gjithashtu mund të vendosen kritere – specifikime të dëshiruara, si shtesë kërkesave dhe specifikimeve të detyrueshme. Dështimi (pamundësia) në përmbushjen e specifikimeve të dëshirueshme nuk do të qojë në refuzimin (eliminimin) e tenderit, sidoqoftë, duke i përmbushur ato, mund të qojë në krijimin e përparësive gjatë fazave të vlerësimit.

Kriteri TEMF është kriteri i përdorur për dhënien e një kontrate publike, që synon të sigurojë **raportin më të mirë çmim/cilësi** ndërmjet cilësisë dhe komponentit financiar të tenderit, duke:

- individualizuar elementet tenderit (**kriteret e vlerësimit**) të cilat pasqyrojnë rëndësinë e dhënë nga AK në plotësimin e nevojave të saj;
- përcaktimin e **peshave** të cilat përfaqësojnë nivelin e paracaktuar të preferencës së AK-së ndërmjet elementeve të ndryshëm të tenderit;
- Caktimin e pikëve për secilin element të tenderit që përcakton nivelin e vlerësimit të AK-së.

PËRDORIMI I KRITERIT TEMF

Përdorimi i TEMF rekomandohet kryesisht në rastet e mëposhtme:

Në përgjithësi kur :

- ***Cilësia është një tipar përkatës i kontratës. Cilësia është e rëndësishme kur, pavarësisht nga çmimi i ofruar, AK merr në konsideratë karakteristikat teknike dhe cilësore të blerjes si një parametër zgjedhjeje.***

Në veçanti kur:

- *Prokurimi i furnizimeve - për kontratat e furnizimeve që përfshijnë instalime të rëndësishme dhe të specializuara të produktit dhe / ose mirëmbajtje dhe / ose aktivitete të trajnimit të përdoruesve, është e zakonshme që dhënia e kontratës të bëhet në bazë të*

kriterit të TEMF. Për këtë lloj kontrate, në fakt, cilësia është normalisht e një rëndësie të veçantë.

- Prokurimi i shërbimeve - për prokurimin e shërbimeve konsulente dhe përgjithësisht të shërbimeve intelektuale, cilësia është normalisht shumë e rëndësishme. Përvoja ka treguar se kur kërkojmë këtë lloj shërbimi, rezultatet më të mira në aspektin e vlerës më të mirë për para arrihen kur përdoret kriteri TEMF.

Kusht thelbësor për përdorimin e kriterit TEMF, në çdo rast, është që karakteristikat, materialet, procesi i prodhimit, kushtet relative kontraktuale të mallrave/shërbimeve/punëve objekt të kontratës të jenë **të prekshme për t'u modifikuar** në drejtim të përmirësimit.

Këto karakteristika, nëse konsiderohen të rëndësishme nga AK, do të përfaqësojnë elementin e tenderit në të cilin do të zhvillohet konkurrimi.

Karakteristikat e referuara **do të lidhen**, në përputhje me nenin 52.3 të LPP-së, jo vetëm me çmimin, por edhe me elementët e cilësisë si:

- kostot që i referohen procesit të ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes;
- kosto të tjera të jetës gjatë periudhës së jetës së blerjes;
- aspektet mjedisore dhe ato sociale që lidhen rreptësisht me objektin e kontratës.

Këto karakteristika do të shprehen në terma të **kritereve të vlerësimit**, duke pasur qëllimin - brenda **peshës së** caktuar për secilin prej tyre duke shprehur nivelin e rëndësisë për AK - për të kthyer vlerësimin/sasinë e secilës karakteristikë të kërkuar në një pikë numerike totale i të cilit do të përbëjë pikët e dhëna për një tender specifik.

Përcaktimi dhe shfrytëzimi i kriterit TEMF kërkon disa **hapa operativë** që AK duhet të ndjekë në përgatitjen e procedurës së tenderit. Veçanërisht:

- 1) **përcaktimi i pikëve maksimale të ofertës teknike dhe financiare;**
- 2) **identifikimin e elementeve të ofertës teknike për vlerësim;**
- 3) **përcaktimi i kritereve të vlerësimit (dhe, nëse janë të pranishëm, nën kritereve) të këtyre elementeve;**
- 4) **përcaktimi i pikës maksimale që do t'i caktohet secilit kriter vlerësimi, duke specifikuar metodën e atribuimit (shpërndarjes).**

Këto aktivitete do të analizohen në detaje në paragrafët e mëposhtëm.

1. PËRCAKTIMI I PIKËVE MAKSIMALE TË OFERTËS TEKNIKE DHE FINANCIARE

Pas përcaktimit të kriterit të shpërblimit të zbatueshëm për procedurën e tenderimit, veprimi i parë që AK-të do të ndërmarrin, kur përdoret kriteri TEMF, është përcaktimi i **pikëve maksimale për dhënien** (pesha totale) tek oferta teknike dhe oferta financiare.

Në çdo rast, shuma e pikëve maksimale për t'i dhënë **komponentit teknik dhe financiar të ofertës** do të jetë e barabartë me **100 pikë**.

REZULTATI TOTALI MAX = Rezultati Teknik maksimal + Rezultati maksimal Financiar = 100 pikë

Prandaj, rezultati maksimal do të përcaktohet nga AK ndërmjet komponentit teknik dhe financiar të ofertës, bazuar në **rëndësinë** e vetë komponentëve.

Për këtë qëllim, AK-të do të marrin domosdoshmërisht parasysh:

- nevojën specifike që duhen plotësuar;
- karakteristikat e tregut specifik;
- karakteristikat e mallit/shërbimit objekt i kontratës;
- veçoritë e tenderit që synojnë të përmirësojnë.

FAKTORET QE UDHEHEQIN PERKUFIZIMIN E PESHES TOTALE

Ka faktorë që mund të sugjerojnë dhënien e **një rëndësie më të madhe** (dhe rrjedhimisht, peshë) **komponentit teknik të ofertës** si p.sh.

- nevoja e theksuar për të **ngritur nivelin e cilësisë** të shërbimeve objekt të kontratës;
- prania, në tregun e referencës, e mallrave/shërbimeve me **karakteristika jo homogjene**;
- rritja e aftësive tekniko-tregtare të konkurrentëve;
- karakteristikat e objektit të mallrave/shërbimeve të kontratës, të cilat mund të kenë një numër përkatës të **elementeve të ndjeshëm ndaj përmirësimit**, në lidhje me karakteristikat teknike, materialet, procesin e prodhimit dhe kushtet kontraktuale;
- veçoritë e tregut të referencës, të karakterizuara nga një nivel i **lartë evoluimi teknik ose aspekte inovative** ;
- nevoja për të promovuar **qëndrueshmërinë në tregun përkatës, në aspektin mjedisor dhe social**;

- prania e një morie operatorësh ekonomik që konkurrojnë për elementët teknikë të mallrave/shërbimeve/punëve të ofruara;
- rreziku që një konkurrencë e lartë në komponentin e çmimit mund të çojë në ulje të tepërta të përshtatshme për të ndikuar **në qëndrueshmërinë**.

Në çdo rast, një pikë e lartë për komponentin teknik justifikohet vetëm kur kontrata paraqet një numër adekuat elementësh cilësorë të ndjeshëm ndaj vlerësimit dhe që tejkalojnë karakteristikat minimale dhe me pasoja të vlerësuara ekonomikisht.

Përkundrazi, konsiderata të tjera duhet të bëjnë AK-të për t'i dhënë **rëndësi më të madhe komponentit financiar të ofertës**, si p.sh.

- nevoja për të siguruar kursime në kosto;
- numrin e parëndësishëm ose papërfillshmërinë e specifikimeve teknike të mallrave/shërbimeve të prirura për t'u përmirësuar, për sa i përket karakteristikave teknike, materialeve, procesit të prodhimit, kushteve kontraktuale;
- evolucioni teknik i reduktuar i tregut objekt i kontratës ose prania e mallrave/shërbimeve me karakteristika homogjene;
- një konkurrencë modeste ekonomike ndërmjet operatorëve ekonomik në tregun e referencës;

AK-të do të përcaktojnë kombinime të ndryshme ndërmjet rezultatit teknik dhe financiar duke marrë parasysh veçoritë e rastit specifik.

BILANCI I PESHAVE

Përcaktimi i totalit të pikëve (100) ndërmjet komponentit teknik dhe financiar të ofertës lihet në **diskrecionin e AK-së**.

Në përgjithësi, AK-të, kur përcaktojnë pikën që do t'i jepet secilit komponent, duhet t'i kushtojnë vëmendje që asnjërit prej komponentëve të ofertës të mos i caktojnë një pikë maksimale **kaq disproporcionale për ta bërë atë pothuajse të parëndësishme** për qëllimin e përcaktimit të rezultatit të përgjithshëm, duke u minimizuar në këtë mënyrë mekanizmi i funksionimit të kriterit të dhënies TEMF.

Sipas praktikës më të mirë, balanca më e mirë në vlerësimin për të garantuar vlerën më të mirë për paranë, **përveç disa situatave specifike që lidhen me veçantinë e tregut (për shembull, blerja e zgjidhjeve inovative ose zhvillimi i furnizimeve të teknologjisë së lartë)**, normalisht përcaktohet duke cituar dy komponentë 60 (oferta teknike) kundrejt 40 pikë (oferta financiare), ose 70 me 30.

Proporcione tjera të pikëve **duhet të arsyetohen me kujdes** për shkak të veçantisë së kontratës dhe në prani të nevojave specifike të AK-së.

Rëndësia e tepërt me **ofertën teknike** (për shembull, një rezultat maksimal më i lartë se 80 pikë) mund të përfshijë sa vijon:

- Duke theksuar rëndësinë e ofertës teknike në dëm të asaj financiar, duke e bërë komponentin financiar të **parëndësishëm për qëllimet e dhënies dhe duke ulur konkurrencën në çmim/kosto, Konkurrentët do të nxiteshin** të ofrojnë çmime që nuk janë shumë të favorshme për AK.
- Ulja e konkurrencës duke përjashtuar OE të aftë për të aplikuar çmime më të mira **kundrejt cilësisë mesatare** (që në çdo rast mund të jetë e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e AK-së. Për shembull, desktopi i PC-ve jo domosdoshmërisht duhet të plotësojë standardet e cilësisë së lartë nëse përdoret për nevoja të përbashkëta)

Përkundrazi, një rëndësi e tepruar **për ofertën financiare** mund të përfshijë:

- një ulje konkurruese në aspektin teknik, në mënyrë që të **shndërrohet në mënyrë implicite procedura e tenderit në një kontratë të dhënë me çmimin më të ulët** .
- Një konkurrencë e tepruar në elementin e çmimit, me pasoja të mundshme në drejtim të ofertave a normalisht të ulëta .

2. IDENTIFIKIMI I ELEMENTEVE TË OFERTËS TEKNIKE PËR VLERËSIM

Pasi të jenë përcaktuar pikët maksimale që do t'i jepen secilit komponent të tenderit, AK do të identifikoj elementët e furnizimit/shërbimit/punës që do të bëhen objekt i propozimeve të tenderuesve dhe vlerësimi i tyre pasues për zgjedhjen e ofertës më të mirë.

Rrjedhimisht, në fazën e hartimit të procedurës së tenderit, AK do të individualizoj brenda (duke u konsultuar me ekspert të sektorit të tregut objekt i kontratës) dhe jashtë (duke kryer analizat e duhura në tregun e referuar) sa vijon:

- 1) **objektivat** që duhen ndjekur me prokurimin. Objektiva të tillë do të renditen për nga rëndësia ndaj të tjerëve dhe do të renditen në përputhje me rrethanat (aktiviteti i tillë i përgjigjet pyetjes së përgjithshme "**Pse i duhet AK ?**");
- 2) **Karakteristikat** e përgjithshme të mallrave/shërbimeve/punës për të blerë. Në veçanti, AK do të identifikojë, midis këtyre elementeve, karakteristikat që do të ofrohen **detyrimisht** (karakteristikat teknike minimale) dhe ato që tejkalojnë minimumin e kërkuar (aktiviteti i tillë i përgjigjet pyetjes së përgjithshme "**Çfarë i nevojitet AK-së ?**");
- 3) Çfarë është **zakonisht në gjendje të ofrojë tregu i referencës** , duke respektuar karakteristikat e individualizuara (një aktivitet i tillë i përgjigjet pyetjes së përgjithshme "**Çfarë ofron tregu ?**");

4) Si rezultat i përputhjes ndërmjet kërkesës së AK dhe ofertës së tregut:

- a) të përcaktojë **karakteristikat minimale teknike** (“kërkesat e detyrueshme”) të kontratës që do të tregohen qartë në dosjen e tenderit; dhe të përcaktojë karakteristikat teknike që përfaqësojnë funksionalitetet/rezultatet/aktivitetet e dëshirueshme që do t'i nënshtrohen vlerësimit dhe mbi të cilat konkurrentët do të duhet të bëjnë një **propozim përmirësimi** në kontekstin e ofertës teknike. Karakteristika të tilla mund t'i referohen **veçorive të ndryshme nga ato të individualizuara si të detyrueshme ose veçorive që tejkalojnë në mënyrë të matshme kërkesat minimale** (aktiviteti i tillë i përgjigjet pyetjes së përgjithshme ' *Çfarë duhet të kërkojë AK për t'u ofruar?*')

5) Karakteristikat e individualizuara përfaqësojnë elementet e vlerësimit të ofertës dhe do të shndërrohen në **kritere vlerësimi** me një peshë përkatëse të caktuar për nga rëndësia.

Këto karakteristika mund t'i referohen, sipas nenit 27.3 të RRPP, kostove operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë, karakteristikave të cilësisë, aspektit funksional, teknik, aspektit mjedisor dhe social, si dhe shërbimit pas shitjes dhe asistencës teknike. Në çdo rast, ato do t'i referohen aspekteve të matshme ose elementeve të prekshme për një vlerësim objektiv.

Të gjithë tenderët duhet të plotësojnë karakteristikat teknike minimale të paracaktuara. Prandaj , tenderët që nuk plotësojnë kushtet minimale të kontratës do të përjashtohen .

Shembull i prokurimit për Furnizime - Blerja e printereve laser

AK ka publikuar një tender për blerjen e printerëve laser duke caktuar disa nga specifikat teknike (numrin e kopjeve për minute). AK ka pranuar 3 oferta , ofertën A, B dhe C.

Oferta Ekonomikisht me e favorshme ne dy rastet e mëposhtme:

1. Nëse, AK printon 10000 faqe ne çdo 6 muaj

2. Nëse AK printon 30000 faqe ne çdo 6 muaj

OFERTAT	Kosto e blerjes	Kosto e tonerit	Numri i faqeve
A	500 euro	175.00 euro	8000
B	600 euro	190.00 euro	10,000
C	750 euro	140.00 euro	8000

Vlerësojmë ofertat me vlerën me te mire për paranë për një periudhe **24 mujore** (sipas dy situatave)?

Varianti i pare

Nëse supozojmë se zyra prodhon rreth **10 000 faqe** çdo **6 muaj**, kostoja reale e printerëve ne një periudhe **24-mujore** është:

Fillimisht kalkulojmë sasinë e kopjeve për 24 muaj: 6 muaj 10000 faqe; **24 muaj 40,000 faqe**;

Për printimin e tyre nevojiten:

Toneri i ofertës A $40000 / 8000 = 5$ toner

Toneri i ofertës B $40000 / 10000 = 4$ toner

Toneri i ofertës C $40000 / 8000 = 5$ toner

Kalkulimi:

- Printer A: $500 + 875 (5 \times 175 \text{ euro}) = 1,375$ euro
- Printer B: $600 + 760 (4 \times 190 \text{ euro}) = 1,360$ euro
- Printer C: $750 + 700 (5 \times 140 \text{ euro}) = 1,450$ euro

Në këtë rast, Printeri B ofron vlerën me të mirë për paranë

Variant i dytë

Supozojmë se zyra prodhon rreth **30 000 faqe** çdo **6 muaj**. Kostoja reale e po këtyre printerëve për atë periudhë **24-mujore** do të jetë:

Fillimisht kalkulojmë sasinë e kopjeve për 24 muaj: **6 muaj 30 000 faqe; 24 muaj 120,000 faqe**

Për printimin e tyre nevojiten:

Toneri i ofertës A $120000 / 8000 = 15$ toner

Toneri i ofertës B $120000 / 10000 = 12$ toner

Toneri i ofertës C $120000 / 8000 = 15$ toner

- A: $500 + 2 625 (15 \times 175 \text{ euro}) = 3 125$
- B: $600 + 2 280 (12 \times 190 \text{ euro}) = 2 880$
- C: $750 + 2 100 (15 \times 140 \text{ euro}) = 2 850$

Për këtë zyre, printeri C, me koston fillestare më të lartë, ofron vlerën më të mirë për paranë.

Prandaj, para përcaktimit të pikëve, duhet të analizohet gjendja e AK dhe të vlerësohet mënyra e përcaktimit të pikëve.

3. PËRCAKTIMI I KRITEREVE TË VLERËSIMIT

Kur kriteri për dhënien e kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm, AK duhet të specifikojë në dosjen e tenderit metodën e vlerësimit të tenderëve duke shënuar peshën përkatëse të faktorëve-elementeve që përcaktojnë kriteret e dhënies për secilin rast.

Vetëm kriteret që mund të vlerësohen në mënyrë objektive dhe kanë qenë të vendosura (përcaktuara) që më parë në dosjen e tenderit mund të përdoren. AK mund të specifikojë vetëm kriteret që kanë të bëjnë me çmimin e tenderit, kushtet e pagesës, funksionimin, mirëmbajtjen dhe shpenzimet tjera për jetëgjatësinë, datën e dorëzimit, kostot objektive funksionale, karakteristikat ambientale apo të ngjashme, kushtet dhe disponueshmërisë së shërbimeve dhe asistencës teknike pas-shitjes, kushtet e ndonjë garancie etj.

Kriteret e vlerësimit dhe domethënia (kuptimi) i tyre relativ duhet të reflekton prioritetin e kërkesave të AK dhe shkallën e rëndësisë të secilit nën kriter (parametër) individual gjatë vlerësimit. Në kushte të përgjithshme , ato duhet të qartësojnë objektivat e kontratës dhe nuk duhet ngatërruar OE të interesuar.

Kriteret e vlerësimit në fakt ndryshojnë për çdo iniciativë specifike të prokurimit. Ato varen, në fakt, nga nevojat specifike të AK.

Për shembull, edhe përballë të njëjtit subjekt të kontratës, një AK mund ta shohë të preferueshem të paguajë më shumë për një produkt që ka kosto të ulëta mirëmbajtjeje sesa të paguajë më pak për një produkt më të lirë që ka një kosto më të lartë mirëmbajtjeje.

Kriteret e vlerësimit do të përcaktohen nga AK në një mënyrë për të garantuar respektimin e **parimeve të transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë**. Për më tepër, ato duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm konkurrence.

LPP kërkon nga AK që gjatë përcaktimit të kriterëve për shpërblimin me kontratë të kenë parasysh respektimin e parimeve bazë të LPP (**Trajtimit të barabartë, Jo-Diskriminim dhe Transparencës së plotë**).

Trajtimi i barabartë dhe Jo diskriminimi

- a. Sipas LPP-së, AK posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë **ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik**

Transparenca

- a. Me qëllim që përcaktimi i kriterëve vlerësuese të bëhet në mënyrë sa më transparente, LPP kërkon nga AK që të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha AK do të sigurojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit;
- b. publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit.

Jo diskriminimi

- a. Eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;
- b. Të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe nen-kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies (vlerësimit) duhet të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit;
- c. që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies; dhe
- d. që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Rrjedhimisht:

- **Rezultati nuk duhet të jetë arbitrar dhe diskriminues.** Me diskrecionin e AK-së në përcaktimin e tyre, kriteret e vlerësimit (nuk do të kenë në asnjë rast **efektin e dhënies së një lirie të pakufizuar sipas zgjedhjes së AK**). Përkufizimi i tyre në fakt duhet të sigurojë mundësinë e konkurrencës efektive, të mos krijojë efekte shtrembëruese dhe të mos lejojë asnjë avantazh për një konkurrent, duke respektuar një tjetër.
- **Të jenë të lidhura me objektin e kontratës.** Kriteret e vlerësimit, do të konsiderohen të lidhura me objektin e kontratës **kur ato kanë të bëjnë** me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen sipas asaj kontrate në çdo aspekt dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët e përfshirë në:
 - o procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

- një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur faktorë të tillë nuk janë pjesë e substancës së tyre materiale.
- **Te jene objektive** në masën më të madhe të mundshme. Kriteret e vlerësimit janë **objektive** kur pasqyrojnë elementë të pranishëm në tregun përkatës dhe të përshtatshme për të vënë të gjithë konkurrentët e pranishëm në treg në pozicionin për të dorëzuar një propozim. Rrjedhimisht, përkufizimi i tyre përfshin referencën ndaj specifikimeve që lejojnë që informacioni i ofruar nga ofertuesit të verifikohet në mënyrë efektive për të vlerësuar se sa mirë ofertat që plotësojnë kriteret e dhënies së kontratës.
- **Ti referohen elementeve të matshëm.** Kriteret e vlerësimit do t'i referohen komponentëve të ofertës, të cilët janë të përshtatshëm për t'u shprehur me numra dhe në këtë mënyrë objektivisht të krahasueshme.
- Të jetë **jodiskriminuese.** Kriteret e vlerësimit nuk duhet të individualizohen që të paragjykojnë ose favorizojnë një konkurrent të caktuar të pranishëm në treg.
- **Të identifikohen dhe të përshkruhet qartë në dosjen e tenderit.** Kriteret e vlerësimit do të parashikohen në dosjen e tenderit dhe nuk lejohet ndryshimi apo zëvendësimi i asnjërës prej tyre pas publikimit të procedurës së tenderit. Ato duhet të shprehen (së bashku me peshat dhe formulën e përdorur për dhënien e pikëve) në mënyrë të qartë dhe të saktë në mënyrë që t'u mundësohet OE të dorëzojë oferta duke pasur njohuri të sakta për nevojat e AK-së dhe rregullat që do të zbatohen për vlerësimin e një tenderi. Vetëm në këtë mënyrë garantohet efektivisht parimi i trajtimit të barabartë dhe transparencës së plotë.
- **Të mos referohen ose të mbivendosen me kriteret e përzgjedhjes.**

KRITERET E PËRZGJEDHJES dhe KRITERET E VLERËSIMIT

Neni 52.4 i LPP-së parashikon se **nuk lejohet asnjë mbivendosje** ndërmjet **kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve të vlerësimit.**

Prandaj, **kriteret e përzgjedhjes** nuk mund të jenë objekt vlerësimi për dhënien e një kontrate publike.

Rrjedhimisht, AK, në dosje të tenderit, do t'i kushtojnë vëmendje diferencës ndërmjet kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve të shpërblimit, në mënyrë që të mos përdorin ato në vend të të tjerave.

Veçanërisht:

- **Kriteret e përzgjedhjes** i referohet kapaciteteve profesionale, teknike dhe financiare të OE, ashtu siç parashikohet në nenin 51 të LPP-së. Ato përdoren për të vlerësuar përshtatshmërinë e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në një procedurë tenderimi dhe për këtë arsye duhet t'u referohen ekskluzivisht kushteve personale të pranueshmërisë dhe kapacitetit të OE përkatëse (në kuptimin, siç u tha më lart, të kapaciteteve profesionale, teknike dhe financiare).
- **Kriteret e vlerësimit** synojnë ekskluzivisht vlerësimin e ofertave të paraqitura për dhënien e kontratës dhe për këtë arsye duhet t'u referohen ekskluzivisht elementeve specifike të ofertës (dhe jo të operatorëve ekonomikë) në lidhje me projektin që do të realizohet. Për rrjedhojë, parimi i përgjithshëm, i parashikuar nga neni 52.2 i LPP-së, që parashikon se kriteret e vlerësimit duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin dhe zbatimin e kontratës.

Si përfundim, AK-të nuk duhet të ngatërrojnë kriteret e përzgjedhjes dhe kriteret e vlerësimit, duke pasur parasysh se të parat i referohen elementeve subjektive të konkurrentit, të dytat në elementë objektivë të kontratës, të cilat mund të përfshijnë vlerësimin e elementeve të konkurrentit, por pikërisht aty ku ndërlikohet me ekzekutimin e thjeshtë të kontratës.

Për shembull, përvoja e mëparshme e operatorit ekonomik me një kontratë të ngjashme nuk duhet të përdoret si kriter shpërblimi, pasi lidhet me përshtatshmërinë e tij të përgjithshme për të zbatuar kontratën. Rrjedhimisht, ai duhet të vlerësohet në fazën e kualifikimit, jo në fazën e shpërblimit.

Llojet e kritereve të vlerësimit. Sipas natyrës së tyre dhe përbërësit të ofertës ku aderojnë, kriteret e vlerësimit ndahen si më poshtë:

- 1) **Kritere që nuk ndërlidhen me koston**, normalisht duke iu referuar **elementeve të ofertës teknike** dhe që lidhen me cilësinë, mjedisin dhe aspektet sociale (**kriteret cilësore**)
- 2) **Kritere që ndërlidhen me koston**, normalisht duke iu referuar **elementeve të ofertës financiare** dhe që lidhen me çmimin dhe kostot (**kriteret sasiorë**).

Më në veçanti, **kriteret që nuk ndërlidhen me koston** mund t'i referohen aspektit të mëposhtëm të kontratës:

- a) cilësinë, e cila përfshin meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale;
- b) Posedimi i një etikete të cilësisë ekologjike, kombëtare ose ndërkombëtare (si Ecolabel i BE-së) në lidhje me mallrat ose shërbimet e mbuluara nga kontrata;
- c) përmirësimi i kushteve të shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve;
- d) aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara;
- e) reduktimi i konsumit të energjisë;
- f) karakteristika inovative;
- g) shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike;
- h) kushtet e dorëzimit si koha e dorëzimit ose ekzekutimit;
- i) kushte që synojnë favorizimin e barazisë gjinore në ekzekutimin e kontratës.

Shembuj të kritereve të **ndërlidhura me koston**:

- a. Çmimi - fillestar i blerjes që deklarohet në çdo ofertë individuale.
- b. Kostot e përdorimit, energjia dhe/ose shpenzimet e karburantit për makineritë dhe pajisjet, ngrohja, ndriçimi, klima etj. për objektet.
- c. Kostot e funksionimit - kostot që lidhen me përdorimin e objektit të prokurimit që mund të përfshijnë kostot për materialin shpenzues (toner, reagensë etj.) pjesët rezerve dhe pjesët konsumuese, kostot e mirëmbajtjes, licencat, etj.
- d. Trajnimet dhe garancitë e pas shitjes.
- e. Kostot për shërbimet pas shitjes - kostot që lidhen me mbështetjen teknike që kërkohet në lidhje me objektin e kontratës

AK-të mund të identifikojnë kriteret të ndryshme dhe shtesë të vlerësimit teknik, me kusht që **ato të lidhen me objektin e kontratës** dhe të lejojnë **një konkurrencë efektive** midis konkurrentëve që operojnë në treg.

Në çdo rast, ato duhet të pasqyrojnë karakteristikën thelbësore të furnizimit/shërbimit/punës dhe të lejojnë konkurrentët të paraqesin oferta që janë mjaft të ndryshme dhe që respektojnë diferencat e pranishme në treg; për rrjedhojë, ato do të kenë të bëjnë me elementë të ofertës që **pasqyrojnë në mënyrë efektive ndryshimet** midis ofertave të ndryshme dhe nxjerrin në pah pikat e forta dhe të dobëta të tyre.

Prandaj, AK-të nuk duhet të individualizojnë kriteret e vlerësimit në lidhje me elementët e ofertës për **të cilat është e sigurt ose shumë e mundshme** që të gjitha ofertat e paraqitura në procedurën përkatëse të **arrijnë nivelin maksimal të cilësisë ose, përndryshe, të mos arrijnë minimumin** .

Kryerja e një **studimi të** duhur të tregut në fazën e projektimit të procedurës do të mbështesë AK-të në individualizimin dhe përpunimin e saktë të kriterëve të vlerësimit. Në fakt, sa më shumë që kriteret pasqyrojnë karakteristikat e blerjeve të ofruara në tregun përkatës, aq më shumë kriteret e individualizuara do të garantojnë vlerën më të mirë për parane.

Nën kriteret. Çdo kriter vlerësimi mund të nën-ndahet në **nën-kritere**, kur është e nevojshme.

Secili nën-kriter paraqet **ndarjen** e kriterit përkatës.

4. PËRCAKTIMI I PIKËS MAKSIMALE QË DO TI CAKTOHET SECILIT KRITER TË VLERËSIMIT, duke specifikuar metodën e atribuimit (shpërndarjes)

Rëndësia e secilit element të ofertës që i nënshtrohet vlerësimit matet duke i caktuar **një peshë** të gjitha kriterëve të vlerësimit të identifikuar.

Peshimi relativ i secilit kriter duhet të tregohet **në përqindje ose në numër në dosjen e tenderit.**

Në rast të më shumë kriterëve të vlerësimit, ose më shumë nën-kritereve brenda një kriteri, secili kriter do të ketë një peshë relative brenda pikës maksimale të parashikuar për komponentin teknik.

Nuk është **e mundur** të përcaktohet një metodë e paracaktuar përgjithësisht për caktimin e peshës së duhur për kriteret e ndryshme pasi kjo do të varet nga vlerësimi dhe gjykimi i AK-së përkatës.

Për më tepër, jo domosdoshmërisht, edhe përballë së njëjtës kontratë, secili AK shpreh të njëjtën rëndësi për të njëjtat aspekte teknike (në varësi edhe të përdorimit që AK i bën furnizimit të prokuruar)

Në çdo rast, pikët maksimale të referuara në kriteret e vetme të vlerësimit nuk do të përcaktohen në **mënyrë jo-proporcionale ose të paarsyeshme** në krahasim me atë të referuar në kriteret e tjera, duke pasur kujdes, në këtë mënyrë, të ruhet ekuilibri i përgjithshëm i ofertës.

Llojet e kriterëve të shpërblimit

Ekziston një gamë e gjerë kriteresh të mundshme që mund të përdoren për të nxjerrë tenderin 'më të mirë', por ato gjithmonë duhet të përshtaten me prokurimin dhe qëllimet e tij. Kur formulohen kriteret e dhënies, është e nevojshme të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- Kriteret e dhënies duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit.
- Duhet të sigurohet një aplikim jo-diskriminues pa mundësinë e një vendimi të mëvonshëm arbitrar.
- Kriteret e cilësisë duhet të mendohen mirë dhe duhet të jenë efektive.
- Një mundësi e renditjes së shkallëzuar është e nevojshme në mënyrë që një renditje reale cilësore e tenderëve të jetë e mundur.
- Kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë nuk mund të përzihen me kriteret e dhënies.
- Kriteret kushtojnë para për tenderuesit - sa më shumë kriteret dhe sa më komplekse të jenë, aq më të larta janë kostot e transaksionit.
- Duhet të merren parasysh dëshmitë që ofertuesit mund të ofrojnë sipas secilit kriter dhe se si do të vlerësohet kjo dëshmi nga AK.

AK mund të marrë parasysh kriteret e ndryshme për të përcaktuar vlerën më të mirë për paranë. Kriteret e shpërblimit mund të ndahen në katër kategori të gjera:

- ✓ **Kriteret Financiare**
- ✓ **Kriteret Cilësore**
- ✓ **Kriteret Kontraktuale**
- ✓ **Kriteret e Qëndrueshme**

1) Kriteret që ndërlidhen me koston (financiare)

Kriteret e lidhura me koston (kriteri ekonomik) lejojnë AK-të që të përcaktojnë koston financiare të blerjes së objektit të prokurimit, si dhe koston e përdorimit dhe funksionimit të tij. Ato i referohen shpenzimeve të financimit të kontratës.

Gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit, AK mund të marrë parasysh:

1. **Kostot e blerjes:** përveç çmimit të një artikulli/shërbimi - dërgimi në vendin e përcaktuar, instalimi, lidhja, testimi, udhëzimi, dorëzimi i dokumenteve të garancisë, marrja (ose lënia) e paketimit etj.

2. **Kostot e përdorimit:** Kostoja e përdorimit duhet të kuptohet si shpenzimi për përdorimin e përditshëm të pajisjes, si p.sh.

- energjia – për pajisjet me energji elektrike, si dhe lënda djegëse për automjetet dhe për energjinë e nevojshme për ndërtesa (ndriçimi, ngrohja dhe ftohja e objekteve)
- kostot e materialeve harxhuese – bojëra, tonerë, reagentë, etj.
- trajnimi
- periudha garantuese

3. **Kostot e mirëmbajtjes:** Kostot e mirëmbajtjes janë kostot e bëra për të mbajtur objektin e kontratës në gjendjen e duhur teknike dhe estetike. Këto mund të përfshijnë:

- pjesë që shpenzohen– pjesë lëvizëse të pajisjeve të kopjimit dhe printimit, automjeteve (jastëkët e frenave, filterat, etj.)
- materialet që i nënshtrohen zëvendësimit periodik.
- kostot e inspektimeve periodike të detyrueshme (p.sh. automjete, vinça, kaldaja, etj.)
- kostot e shërbimeve të mirëmbajtjes.

4. **Kostot e asgjësimit:** Ato duhet të përfshihen nëse ekzistojnë. Në këtë rast, çmontimi mund të përfshijë kosto specifike dhe të konsiderueshme. Për rrjedhojë, kur AK vendos të përdorë objektin e kontratës deri në asgjësimin e tij, duhet të marrë parasysh këto kosto. Kur është planifikuar të shitet artikulli pas një periudhe të shkurtër përdorimi, humbja e vlerës duhet të merret parasysh.

2) Kriteret cilësore

Kriteret cilësore kanë të bëjnë me kërkesat dhe specifikimet kryesore të performancës si cilësia e objektit të prokuruar, meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, kushtet e dorëzimit, kushtet e pagesës, shërbimi pas shitjes etj.

Cilësia e subjektit të tenderit përcaktohet kryesisht nga kushtet – kërkesat të cilat duhet të plotësohen siç përshkruhet në lëndën e tenderit. Megjithatë, AK mund të kërkojë një cilësi më të lartë se minimumi.

Për shembull për Furnizimet, cilësia e produkteve mund të kuptohet në mënyra të ndryshme:

- a. parametrat teknike
- b. funksionet e produktit
- c. punimi cilësor i produktit
- d. materialet e përdorura për prodhim
- e. qëndrueshmëria e pajisjes
- f. teknologjitë, makineritë, pajisjet e përdorura në prodhim
- g. vlerat estetike dhe/ose dizajni i produktit.

Mënyra më e përshtatshme për të aplikuar kriteret e cilësisë për mallrat duket se është përmes parametrave teknikë dhe cilësorë. Parametrat bazë teknikë dhe cilësorë duhet të specifikohen në formën e kushteve minimale.

Këshilla për përcaktimin e kriterëve të cilësisë për furnizimet:

- a. Listoni parametrat dhe funksionet që do të vlerësohen.
- b. Për të shmangur çdo dyshim, është mirë të tregohet qartë nëse kriteri i parametrave të specifikuar është në rritje (sa më shumë, aq më mirë), apo në rënie (sa më pak, aq më mirë).
- c. Specifikoni, në rastin e parametrave të vazhdueshëm, diapazonin e kornizës brenda së cilës do të vlerësohet parametri: pragu i poshtëm (minimumi) është shuma e përcaktuar si kusht, ndërsa ai i sipërm (optimumi) është vlera optimale, pas së cilës gjë AK bëhet indiferent dhe nuk rezulton në rritje të numrit të pikëve kur tejkalohej parametrat.
- d. Përdorni një vlerësim me dy vlera në rastin e parametrave ose funksioneve të vlerësuara "po-jo": në rastin kur funksioni ofrohet - ofertës i jepet një numër i caktuar pikësh dhe, nëse jo, oferta merr zero pikë.
- e. Specifikoni peshën e parametrave: duke supozuar se një numër i caktuar pikësh mund të merret brenda një kriteri të caktuar, është e nevojshme të ndahet grupi i pikëve të mundshme ndërmjet secilit parametër të vlerësuar.
- f. Përcaktoni metodën e pikëzimit duke supozuar se tenderimi i parametrave në nivelin minimal rezulton në dhënien e 0 pikëve, ndërsa në nivelin optimal numrin maksimal të pikëve që mund të merren për këtë parametër.

Shembull i prokurimit për Furnizime - Blerja dhe instalimi i aparaturës radiologjike XRY

Kriteri: **Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm**

1. Çmimi më i ulët (përfshirë edhe instalimin): **60 pikë**
2. Çmimi i materialit shpenzues për periudhën 5 vitet e ardhshme: **25 pikë**
3. Periudha më e gjatë garantuuese duke përfshirë mirëmbajtja dhe servisimi (2 vite granacioni minimal, për çdo vit shtesë 5 pikë deri maksimum 5 vite): **15 pikë.**

Totali: 100 pikë

Oferta	Çmimi me i ulet 60 pike			Çmimi i materialit shpenzues (Filmat) për 5 vite 25 pike			Periudha garantuese (min. 2 vite, për çdo vit shtese 5 pikë)		Totali Pikë	Renditja
	Çmimi	Pesha	Pikët	Kosto e materialit shpenzues	Pesha	Pikë	Vite	Pikë		
A	180,000.00	100	60.00	80,000.00	81.25	20.31	2	0	80.31	3
B	193,000,00	93.26	55.96	72,500.00	89.65	22.41	3	5	83.37	2
C	212,420,00	84,73	50.84	65,000.00	100	25.00	5	15	90.84	1

Vlerësimi :

- Pikët për tenderin me çmimin me te ulet llogariten: Çmimi më i ulët x 100/Çmimin e tenderit.
- Pikët për koston e shpenzimeve llogariten sikur edhe çmimi me i ulet.
- Piket për periudhën garantuese mbi dy vite - për çdo vite shtese nga 5 pike, maksimum 15 pike për garancinë 5 vitë.

Oferta C me çmimin prej 212,420.00 €, bazuar në kriteret e vlerësimit, shpërblehet me kontratë pasi është renditë në vendin e parë me gjithsej 90.84 pikë.

Shembull për Furnizim me automjete

Kriteri: Tenderi Ekonomikisht me i favorshëm

1. Çmimi: **60 %**
2. Shpenzime mesatare të karburantit në 100 km ne ciklin e përzier urban dhe nder - urban: **20 %**
3. Shërbimet pas shitjes- servisimi i rregullta sipas manualit te përdorimit te automjetit: **20 %**

	Ofertat		
Nenë kriteret	A	B	C
Çmimi	450,000.00	470,000.00	420,000.00
Shpenzimi i karburantit	6.00 L/100 KM	5.20 L/100 KM	6.50 L/100 KM
Shërbimet pas shitjes - servisimi i rregullt sipas manualit të përdorimit të automjetit në muaj	36 muaj	24 muaj	24 muaj

Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik fitues sipas llogaritjes së pikëve:

Oferta	Çmimi 60 %			Shpenzimet e karburantit 20%			Shërbimet pas shitjes 20 %			Totali i Pikëve	Renditja
	Çmimi	Pesha	Piket	Shpenzimi	Pesha	Piket	Muaj	Pesha	Piket		
A	450,000	93.34	56.01	6.00	86.67	17.34	36	100	20.00	93.35	1
B	470,000	89.37	53.63	5.20	100	20.00	24	66.67	13.34	86.97	3
C	420,000	100	60.00	6.50	80.00	16.00	24	66.67	13.34	89.34	2

Oferta A me çmimin prej 450,000.00 € , bazuar në kriteret e vlerësimit, shpërblehet me kontratë pasi është rendite në vendin e parë me gjithësej 93.35 pikë.

Shembull për Furnizim me Kamionçinë

Shembulli i mëposhtëm ilustron përdorimin e tenderit ekonomikisht më të favorshëm bazuar në raportin më të mirë **çmim/cilësi** në prokurimin e një automjeti. Kërkesat në dokumentin e tenderit janë:

Kërkesat minimale të Specifikimit teknik

1 kamionçinë (me një kabinë)

- Minimumi 1000 kg kapacitet mbajtës
- motor benzine me minimum 150 kuaj fuqi (H) në RPM
- të dorëzohet brenda minimumit 4 dhe maksimum 8 javësh nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e dhënies së kontratës: raporti më i mirë çmim/cilësi - 80/20

a) Teknik (kriteret jo çmimi): deri në maksimum 20 pikë

Nën-kriteri 1: Kapaciteti i ngarkesës - Për çdo 100 kg mbi 1000 kg Autoriteti Kontraktues do të jap 5 pikë deri në maksimum 10 pikë.

Nën-kriteri 2: Kuajfuqia e motorit - Për çdo 1 HP mbi 150 HP Autoriteti Kontraktues do të japë 1 pikë deri në maksimum 10 pikë.

b) Financiare (kriteret e lidhura me çmimin): deri në maksimum 80 pikë

Nën-kriteri 1: Çmimi

Nën-kriteri 2: Periudha e dorëzimit - Tarifa prej 300 EUR për çdo javë do t'i shtohet çmimit të ofruar (nënkriteri 1) për çdo javë të dorëzimit përtej 4 javëve deri në një maksimum të lejuar dorëzimi prej 8 javësh nga nënshkrimi i kontratës.

Nën-kriteri 3: Çmimi i listës së pjesëve rezervë të përzgjedhura nga AK të përfshira në dokumentin e tenderit - Çmimi i listës do t'i shtohet çmimit të ofruar.

Totali i kriterëve të lidhura me çmimin llogaritet duke shtuar tre nënkriteret financiare (Çmimi + Periudha e dorëzimit + Lista e pjesëve të këmbimit). Tenderi me totalin më të ulët të kriterëve të lidhura me çmimin merr numrin maksimal të pikëve të parashikuara për këtë kriter (80).

Tenderët do të vlerësohen në bazë të formulës së mëposhtme:

- **Çmimi më i ulët i tenderit / Çmimi i tenderit që vlerësohet x 80**

Autoriteti Kontraktues ka pranuar dy tenderë me elementët e mëposhtëm:

Nen kriteret	Oferta A	Oferta B
kapaciteti	1000 kg	1200 kg
kuajfuqi	155 HP	160 HP
çmimi	20 000 EUR	22 000 EUR
afati	5 jave	7 jave
Lista e pjesëve rezerve	800 EUR	1 000 EUR

Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik fitues sipas llogaritjes se pikëve:

	Kriteri	Oferta A	Oferta B
1	Kriteri teknik (KT):		
	kapaciteti	0	10
	kuajfuqi	5	10
	Piket për KT	5	20
2	Kriteri financiar (KF):		
	çmimi	20 000	22 000
	Tarifa për pagesën për me shume se 4 jave	300	900
	Lista e pjesëve rezerve	800	1 000
	Totali i çmimit:	21100	23900
	Piket për KF:	80	70.627
	Total KT + KF	85	90.627
	Renditja	2	1

Oferta B, bazuar në kriteret e vlerësimit, shpërblehet me kontratë pasi është renditë në vendin e parë me gjithsej 90.627 pikë.

Shembull për Autoambulanca

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm bazohet në dy kritere:

Kriteri i shpërblimit	Piket
Çmimi	50
Afati	50
Total	100

1. Çmimi

Tenderi me çmimin më të ulët merr numrin maksimal të pikëve të parashikuara për këtë kriter (50). Tenderët e mbetur do të vlerësohen në bazë të formulës: **Çmimi më i ulët i tenderit / Çmimi i tenderit që vlerësohet x 50,**

2. Afati kohor

Kriteri i shpërblimit	javët	piket
Afati	< 10 jave	50
	< 14 dhe ≥ 10 jave	40
	< 18 dhe ≥ 14 jave	30
	< 20 dhe ≥ 18 jave	20
	≥ 20 jave	10

AK ka pranuar 4 oferta

	Çmimi (EUR)	Afati
Oferta A	5,000	≥ 20 jave
Oferta B	15,000	< 14 dhe ≥ 10 jave
Oferta C	17,000	< 14 dhe ≥ 10 jave
Oferta D	19,000	< 10 jave

	Piket për çmim	Piket për afat	Total
Oferta A	50	10	60
Oferta B	17	40	57
Oferta C	15	40	55
Oferta D	13	50	63

Oferta D, bazuar ne kriteret e vlerësimit, shpërblehet me kontrate pasi është rendite ne vendin e pare me gjithsej 63 pike.

Shërbimet e konsulences

Përshkrimi i kriterëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve krijon më së shumti vështirësi.

Në rastin e shërbimeve intelektuale, cilësia lidhet me kompetencën e personave që janë të përfshirë në përmbushjen e kontratës. Kompetencat mund të përfshijnë arsimin dhe përvojën dhe kualifikimet e konfirmuara nga lloje të ndryshme certifikatash.

Për këtë lloj kriteri zakonisht përdoren qasjet e mëposhtme: “*për çdo vit përvojë ... pikë*”, “*për pjesëmarrje në çdo projekt të mëpasshëm që përbëhet nga në natyrë..... pikë*”.

Kriteri tjetër për shërbimet që fokusohet në qasjen e OE ndaj realizimit të kontratës së ardhshme mund të jetë koncepti i ekzekutimit të kontratës. Në këtë rast, OE është i detyruar të përshkruajë qasjen ndaj kontratës në objektin e përcaktuar nga AK. Detyra e AK është të përcaktojë fushën e informacionit të kërkuar dhe mënyrën e vlerësimit të qasjes së OE. Secili nga operatorët ekonomik prezanton metodën e tij për të përfunduar kontratën bazuar në përvojën e tij.

Vlerësimi i propozimeve teknike merr parasysh disa kriterë, të tilla sikurse:

Kriteret	Pesha	
Përvoja specifike	0-10	Një maksimum prej 10 pikave mund të caktohet për përvojën specifike të konsulentëve, pasi që AK I kishte përzgjedhur ata në bazë të aftësive të tyre, kualifikimeve dhe përvojës në projekte të kësaj natyre.
<p>Përshtatja e metodologjisë/planit të punës. Nen kriteret që do të përdoret për të vlerësuar këtë komponent janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ <i>Qasja teknike dhe metodologjia</i> ✓ <i>Plani i Punës</i> ✓ <i>Organizimi dhe stafi</i> 	20-50	<p>Metodologjia dhe plani i punës është një komponent kyç i propozimit teknik dhe duhet të vlerësohet me kujdes.</p> <p>Qasja teknike dhe metodologjia:</p> <p>Këtu konsulentët shpjegojnë se kane kuptuar objektivat e detyrës, nxjerrin në pah çështjet që do të trajtohen dhe rëndësinë e tyre, dhe shpjegojnë metodat teknike që do të ndërmarrin për trajtimin e tyre. Mandej ata duhet të sqarojnë metodologjitë që propozojnë për të miratuar, për të demonstruar pajtueshmërinë e këtyre metodologjive me qasjen e propozuar (p.sh., metodat e interpretimit të të dhënave në dispozicion, kryerjen e hetimeve; analizat dhe studimet; duke krahasuar zgjidhje alternative); dhe adresojnë ndonjë ndryshim në TOR të propozuar nga konsulentët.</p> <p>Plani i Punës:</p> <p>Këtu konsulentët propozojnë aktivitetet kryesore të detyrës - përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e tyre; fazat</p>

		<p>dhe marrëdhëniet e tyre; afatet (përfshirë miratimet e përkohshme nga ana e AK-së); dhe datat e dorëzimit të raporteve më të rëndësishme. Përputhshmëria e qasjes teknike dhe metodologjisë me planin e propozuar të punës, është një tregues i mirë që konsulentët kanë kuptuar TeR dhe janë në gjendje për ti përkthyer ato në një plan të mundshëm të punës. Një listë e dokumenteve finale, përfshirë raportet, vizatimet, dhe tabelat që do të dorëzohen si prodhime përfundimtare, duhet të përfshihet këtu. Plani i punës do të mundësojë konsulentët për të përgatitur orarin e Aktiviteteve.</p> <p>Organizimi dhe stafi:</p> <p>Në këtë seksion konsulentët propozojnë strukturën dhe përbërjen e ekipit të tyre. Ata do listojnë disiplinat kryesore të përfshira, ekspertet përgjegjës dhe stafin teknik dhe mbështetës te propozuar.</p>
<p>Kualifikimet e stafit kryesor</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Udhëheqësi i projektit ✓ Eksperti Kyç 2 	<p>30-60</p>	<p>Stafi kyç i referohet stafit të konsulentit që ka përgjegjësinë e menaxhimit ose kane kualifikimet kryesore që nevojiten për detyrën. Stafi kyç i Konsulentit vlerësohet ne baze të kualifikimit dhe përvojës e treguar në CV e tyre.</p> <p>Kualifikimet e përgjithshme: Ky nën-kriter përfshin përvojën e përgjithshëm të kandidatit (kohëzgjatjen e përgjithshme te aktivitetit profesional), nivelin e arsimimit dhe trajnimit, pozitat e mbajtura nga kandidati, koha e kaluar nga konsulenti si stafi, dhe përvojën në rajon ku do te kryhet projekti.</p> <p>Përshtatshmëria për kryerjen e detyrës: Kjo ka të bëjë me edukimin e kandidatit, trajnimit dhe përvojën në sektorin specifik, qe ndërlihet drejtpërsëdrejti me detyrën dhe pozitën e propozuar. Ky faktor është kritik dhe duhet t'i jepet peshë më të lartë në mesin e tri nën-kritereve.</p> <p>Përvoja në Rajon dhe Gjuha (për projekte ndërkombëtare): Kjo tregon njohuritë e kandidatit me kushtet kombëtare ose vendore, duke përfshirë kulturën, sistemet administrative dhe organizatat qeveritare, dhe aftësia e tij / saj për të komunikuar në gjuhën kombëtare.</p>

Transferimi i njohurisë (opsionale)	0-10	Numri i pikëve do të përcaktohet duke marrë parasysh tre nën-kriteret e mëposhtme: 1) Lidhja e programit të trajnimit; 2) Qasja e Trajnimit dhe metodologjia; dhe 3) Kualifikimet e ekspertëve dhe trajnerëve
Pikët totale	100	

Komisioni i vlerësimit do ti vlerësoj propozimet teknike në bazë të përgjegjësisë së tyre ndaj Termave të Referencës, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret, dhe **sistemin e shënuar në dosje te tenderit.**

Propozimit me çmimin më të ulët do ti epet rezultati financiar 100 pike si dhe propozimet tjera marrin rezultate financiare që janë reciprokisht proporcionale me çmimet e tyre të ofruara. Rezultati i peshuar i propozimit financiar duhet të specifikohet në KPP, dhe mund të jetë deri në 30 pikë

Piket totale do të fitohen duke bashkuar piket e peshuara për **cilësinë (propozimi teknik)** dhe **kostoja (propozimi financiar).**

Shembull: Vlerësimi i kombinuar ne shërbime te konsulences

Kompania e konsulences	Piket totale TP	Piket totale TP $St = 100 \times T/Tm \times 90\%$	Çmimi nga FP	Piket totale FP $Sf = 100 \times Fm/F \times 10\%$	Piket totale TP+FP	Renditja
A	86	77.4	210.000	7.61	85.01	3
B	91	81.9	230.000	6.95	88.85	2
C	73	65.7	160.000	10	75.7	4
D	94	90	380.000	4.21	94.21	1

$St = 100 \times T/Tm \times 90\%$, ku St janë piket për propozimin teknik, T janë piket teknike te ofertës ne shqyrtim dhe Tm janë piket me te larta te propozimit teknik.

$Sf = 100 \times Fm/F \times 10\%$, ku Sf jane piket për propozimin financiar, Fm është çmimi me i ulet dhe F çmimi i propozimit ne shqyrtim.

Kontratat për punë

Në rastin e kontratave të punëve të bazuara në dokumentacionin e projektit, pjesa më e madhe e kërkesave për cilësinë e punimeve, materialeve dhe produkteve përcaktohet në dokumentacionin e projektimit dhe specifikimet teknike. Kjo nuk përjashton përdorimin e kriterëve që promovojnë cilësinë e produkteve ose metodave që do të përdoren gjatë ekzekutimit të kontratës. Cilësia mund të mbulojë aspekte të tilla si:

- a. Menaxhimi i cilësisë, sigurimi i kontrollit të pavarur të cilësisë, minimizimi i mangësive, përdorimi efektiv i mjeteve të prodhimit
- b. orari, piketa, koha e reagimit ndaj ngjarjeve
- c. përshkrimi i qasjes për zbatimin e secilit operacion brenda orarit
- d. Identifikimi i rrezikut, përshkrimi i ndikimit të rrezikut të pritshëm në plan dhe kostot dhe përshkrimi i masave të propozuara për të shmangur ose reduktuar rrezikun (nuk duhet të përfshijë ndonjë rishpërndarje të rrezikut)
- e. Afat kohor i përfundimit të punëve
- f. Afati i periudhës garantuese

Shembull i prokurimit për Punë: Ndërtimi i rrugës "X"

Nr	Nën-kriteri	Koeficient
1	Çmimi	70
2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në maksimum 180 ditë. AK do të vlerësojë afatet kohore konform normave dhe standardeve ndërtimore, ku është vlerësuar minimumi dhe maksimumi i afatit për implementim të këtij projekti, duke u bazuar në kapacitetet teknike dhe profesionale që kanë OE. < 120 ditë ≥ 80 ditë = 20 pikë < 140 dhe ≥ 120 ditë = 15 pikë < 160 dhe ≥ 140 ditë = 10 pikë < 180 dhe ≥ 160 ditë = 5 pikë	20
3	Afati me i gjatë i Periudhës Garantuese deri në max 10 vite	10
	Totali	100

Në këtë rast AK do të duhet të kërkojë nga OE që me oferte të dozojnë edhe Planin Dinamik të detajuar në mënyrë që të shqyrtohen se a janë parapare afatet në përputhje me normat dhe standarde ndërtimore. Gjithashtu, në lidhje me periudhën e garancionit, AK duhet të përcaktojë në Dosje të Tenderit se çka mbulon Garancioni.

Shembull i prokurimit për Pune: Ndërtimi i tregut të gjelbërt

Kategoritë		Përshkrimi i kriterëve	Pesha
1	Çmimi	Pikët <100 x 80%> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	80%
2	Mirëmbajtja e objektit	Pikët <100 x 20%> për tenderin me çmimin më të ulët për mirëmbajtje. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	20%

- *Pikët <100 x 80%> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht*
- *Pikët <100 x 20%> për tenderin me çmimin më të ulët për mirëmbajtje. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht*

Ne këtë rast AK do të duhej të përcaktoj numrin e viteve për periudhën garantuese (p.sh vite) dhe të përshkruaj se çka mbulon Grancioni. Gjithashtu, ne dosje të tenderit AK duhet të tregoj se **Cmimi i ofertuar për mirëmbajtje do të perpjestohet dhe do të paguhet në baza mujore.**

Shembull i nën kriterëve:

- **Llambat ekonomike**
Llambat ekonomike janë zgjedhja e duhur për ndriçimin e ambienteve të shtëpisë, pasi që jo vetëm që ndihmojnë në faturat e energjisë elektrike, por edhe janë mjaft efikase në ndriçimin e **hapësirave të mëdha. Pra madhësia e hapësirave mund të jete një nder nën kriteret.**
- **Llamba LED**

Llambat LED janë zgjidhja më ekonomike për ndriçimin pasi që jo vetëm që përdorin shumë më pak energji sesa ndriçuesit fluoreshentë, por edhe kanë një **jetëgjatësi të lartë**, mesatarisht 20 vjet ose 10,000 orë përdorimi. **Pra jetëgjatësia mund të jete një nder nën kriteret.**

3) Kriteret kontraktuale

Kriteret kontraktuale i referohen mënyrës në të cilën do të kryhet kontrata (detyrimet kontraktuale), p.sh., afati për ekzekutimin e kontratës (përfundimi i punëve, dorëzimi i mallrave, etj.), përgjegjësia kontraktuale, etj.

Kriteri i kontraktual më i përdorur dhe sigurisht (për fat të keq) me i keqpërdorur është afati për implementimin e kontratës. Afati i përfundimit të kontratës në shumicën e rasteve duhet të jetë kusht dhe jo kriter për vlerësimin e tenderëve.

Ne rastet, kur shpejtësia e ekzekutimit është e konsiderueshme, nuk është e arsyeshme të heqësh dorë nga ky kriter, por zakonisht afatet shkurtohen aq shumë sa shkurtimi i mëtejshëm mund të ndikojë negativisht në cilësi. Nga ana tjetër, ky kriter shpesh zbatohet në atë mënyrë që të mos ketë ndikim në rezultatin e procedurës, pasi të gjithë kontraktorët ofrojnë periudhën optimale të shkurtimeve.

Nëse AK përcakton një afat për ekzekutimin e kontratës, si kriter vlerësimi AK duhet të sigurohet që kontraktori ta respektoj këtë afat. Kriteri i afatit të implementimit të kontratës (Plani dinamik) duhet të përdoret për të verifikuar respektimin e afatit të deklaruar.

Klauzolat sociale: në këtë rast OE është i obliguar që të plotësojë këtë kusht d.m.th. është kusht kontraktual.

- **Shembull:** 2% e shumës totale të kontratës duhet të ekzekutohet nga personat e papunë, me aftësi të kufizuar ose të marginalizuar

4) Kriteret e Qëndrueshme

Kriteret sociale

Gjatë zbatimit të prokurimit publik, njerëzit dhe grupet e pa favorizuara mund të mbështeten në një masë të caktuar. Pika fillestare për formulimin e kërkesave në këtë fushë është identifikimi i nevojave sociale dhe krahasimi i tyre me qëllimin e tenderit. Pyetja për t'u përgjigjur është nëse prokurimi mund të prekë grupet e pa favorizuara, çfarë lloj ndihme kanë nevojë për këto grupe dhe a mund të plotësohen nevojat e tyre me zbatimin e tenderit, apo mund të përdoren kompetencat e tyre gjatë procesit të tenderit. Kriteret sociale mund të përfshijnë në veçanti:

- a. Detyrim për të rekrutuar persona të papunë, dhe në veçanti persona të cilët nuk janë në punë për një periudhë të gjatë;
- b. Detyrim për të rekrutuar persona të hendikepuar dhe me aftësi të kufizuar;
- c. Për të themeluar programe trajnimi për të papunët apo për të rinjtë gjatë zbatimit të kontratës;
- d. Detyrim për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë gjinore apo diversitetit mbi baza të tjera; apo
- e. Detyrim për të qenë në përputhje me substancën e dispozitave të konventave themelore të ILO-së gjatë ekzekutimit të kontratës, nëse këto dispozita nuk janë zbatuar në ligjin respektiv.

Klauzolat sociale (çmimi më i ulët): ne këtë rast OE është i obliguar që të plotësojë këtë kusht d.m.th. është kusht kontraktual.

- **Shembull:** 2% e shumës totale të kontratës duhet të ekzekutohet nga personat e papunë, me aftësi të kufizuar ose të margjinalizuar

Kriteret sociale (TEMF): ne këtë rast OE merr pike shtese ne rast se propozon ekzekutimin e kontratës nga persona me aftësi të kufizuar.

- **Shembull:** 2% (obligimi sipas kontratës) dhe pikë shtesë deri në 5% të shumës totale të kontratës nëse kontrata realizohet nga personat e papunë, me aftësi të kufizuar dhe të margjinalizuar

Kriteret Mjedisore

Prokurimi publik nuk duhet të kontribuojë në degradimin e mjedisit natyror dhe duhet të promovohen metodat e prokurimit që kursejnë burimet natyrore dhe zbutin ndikimin në mjedisin natyror. Më poshtë janë disa kritere mjedisore që mund të përdoren:

- a. minimizimi i konsumit të energjisë
- b. minimizimi i konsumit të energjisë elektrike, ngrohjes dhe gazit si dhe ujit nëpër ndërtesa
- c. minimizimi i konsumit të karburantit nga automjetet
- d. përdorimi i produkteve të riciklueshme ose të riciklueshme
- e. zbatimin e shërbimeve dhe punimeve duke përdorur makineri dhe teknologji të kursimit të energjisë